



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimet ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100277/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandim në lidhje me kushtet në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr. 1 Tiranë, në zbatim të detyrave të lënë nga CPT.*

Drejtuar: **Kryekomisar Bujar MEHMETI**
Shef i Komisarariatit të Policisë nr. 1 Tiranë

TIRANË

Për dijëni: **Drejtues i Parë Lorenc PANGANIK**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Të nderuar,

Sikurse ju kemi vënë në dijeni, institucionin e Avokatit të Popullit ka filluar me nismën e vet kryrjen e një inspektimi tematik në Komisarariatit të Policisë nr. 1 Tiranë. Avokati i Popullit ka ngritur grupin e punës të përbërë nga ndihmës komisionerët të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës trajtimet ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, dhe ndihmës komisionerja e seksionit të Veçantë. Ky grup në cilët me datë 10.02.2021 inspektoi Komisarariatit të Policisë nr.1, Tiranë, në kuadër edhe të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga CPT, gjatë vizitës inspektuese në vitin 2018 në Shqipëri, lidhur me kushtet në ambientet e sigurisë së këtij komisarariati.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të lënë nga CPT gjatë vizitës inspektuese në vitin 2018, në Shqipëri si dhe rekomandimet të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Fillimisht grupi i punës kontaktoi me shefin e komisarariatit, i cili u vu në dijeni të qëllimit të inspektimit. Më tej, ai na informoi mbi gjendjen dhe kushtet në të cilat ndodhen ambientet e dhomave të sigurisë në këtë institucion, numrin e dhomave, kapacitetin e mbajtjes së personave të

ndaluar/arrestuar, si dhe për garantimin e të drejtave të këtyre personave brenda standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe dokumentet ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Në lidhje me interesimin e grupit të inspektimit, për zbatimin e rekomandimit të CPT-së, në kuadër edhe të përgjigjes së Qeverisë Shqiptare (DPP Shtetit)¹, drejtuesit të komisariatit iu kërkua të vihej në dispozicion kopjet e urdhrave për mbylljen e dhomave të sigurisë që ishin më pak se 5m², të cilat sipas raportit të CPT-së nuk plotësonin kushtet për jetesë normale dhe kriteret për ndërtimin e dhomave të sigurisë, sikurse parashikohen edhe në procedurat standarde².

Nga informacioni, rezultoi se për periudhën që kishte qënë në detyrë rreth 7 muaj, nuk ishte në dijeni të urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për mbylljen e dhomave të sigurisë sipas detyrave të lëna nga CPT.

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi me inspektimin në ambientin e dhomave të sigurisë, me qëllim evidentimin e kushteve në të cilat ndodhen këto dhoma.

Nga inspektimi në vend i ambienteve, u konstatua se:

- Në katin e parë të këtij komisariati **ndodhej vetëm 1 dhomë sigurie** për persona të ndaluar/arrestuar, me përmasa 4x2m dhe me kapacitet për 4 persona. Kjo dhomë ishte përshtatur pas rrëzimit të një muri ndarës që kishte ekzistuar më parë, duke bashkuar kështu dy dhoma ekzistuese;
- Dhoma nuk plotësonte standardet minimale të jetesës, pasi sipërfaqja e dhomës ishte më pak se 5m² për person, dritarja e saj ishte e vogël dhe nuk lejonte qasje për dritën natyrore, ndriçimi artificial ishte i papërshtatshëm dhe ajrimi i pamjaftueshëm;
- Dhoma nuk kishte asnjë krevat, por kishte vetëm 4 dyshekë sfungjeri dhe personat e ndaluar ishin të detyruar të flinin në këta dyshekë të vendosur në dysheme. Gjithashtu, nuk kishte asnjë pajisje për ruajtjen e kushteve higjeno-sanitare;
- Nisur nga sipërfaqja e vogël dhe kubatura e dhomës së sigurisë, ajo nuk ishte e mjaftueshme për kapacitetin fizik dhe akomodimin e 4 personave.
- Në ambientin e sigurisë, **ndodhej një dhomë tjetër me përmasa 2x1.5m, e cila ishte e mbyllur me çelës dhe e vulosur** dhe (sipas informacionit) nuk përdorej për akomodimin e personave të arrestuar apo ndaluar. Për këtë na u vu në dispozicion procesverbali nr.846-B prot., datë 07.07.2020 “Mbi mbylljen e një dhome në ambientet e sigurisë të Komisarariatit”, ku referohet

¹ Rekomandimi nr.8, faqe 13-14, <https://rm.coe.int/16809cb571>

² Kreu VIII, pika 3 e Procedurës Standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

se dhoma u pastrua, u mbyll me dryn dhe u vulos me plastelinë për të mos u hapur dhe përdorur nga punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë. Bashkëlidhur procesverballi.

- Po ashtu, një ish dhomë sigurie me përmasa 3x2m, ishte e përshtatur nga bashkimi i dy dhomave të vogla, në **një ambient ku konsumoheshin vaktet e ushqimit** nga personat e ndaluar/arrestuar. Aty ndodhej një tavolinë e madhe dhe 6 karrige.
- Një dhomë tjetër e cila deri në muajin Janar 2021 shërbente për konsumimin e vakteve të ushqimit, ishte përshtatur si **zyrë më vete për intervistimin dhe marrjen e gjurmëve të gishtave, të personave arrestuar/ndaluar**. Dhoma ishte e pajisur me tavolina, karrige për qëndrimin ulur të shtetasve, si dhe me orënditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë. Ky ndryshim, ka ardhur si pasojë e forcimit të masave të sigurisë për personat e ndaluar dhe arrestuar, duke marrë shkas nga ngjarja e fundit që ka ndodhur në ambientet e këtij institucionit ku në muajin janar të vitit 2021 një shtetas i arrestuar është arratisur nga ambientet e Komisarariatit nr.1 Tiranë. Kjo ka ndodhur në momentin kur efektivet e policisë e kishin nxjerrë nga ambientet e sigurisë për marrjen e shenjave të gishtave.
- Gjithashtu, në korridorin e ambienteve të sigurisë, ndodhej edhe zyra e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, e cila shërbente njëkohësisht edhe si dhomë për mjekun për kryerjen e vizitave mjekësore.
- Ne jemi vënë në dijeni, se është nënshkruar kontrata nr.1412, datë 14.08.2019 me operatorin “HASTOÇI” shpk, për ndërtimin e zonës së sigurisë në LPD Tiranë. Afati i ndërtimit sipas kontratës ishte 24 muaj, pra duhet të kishte përfunduar brenda vitit 2021. Por në inspektimin e bërë nga Avokatja e Popullit Erinda Ballanca, Komisionerja e MKPT Ermonela Xhafa dhe Komisionerja e Seksionit të Veçantë Ermonela Ruspi, në datë 11 janar 2022, në këto ambiente, u konstatua se punimet kishin mbaruar përgjithësisht, por kishte ende disa zëra të pa realizuar, si psh vendosja e zgarave të sigurisë në disa prej ambienteve të administratës, si dhe nuk ishte kryer mobilimi i plotë i ambienteve/zyrave.

Përgjegjësi i dhomave të sigurisë, kishte një raft të veçantë në dhomën e tij të punës, ku mbante dhe administronte dokumentet dhe regjistrin për evidentimin e personave të arrestuar/ndaluar, regjistrin e sendeve personale, regjistrin e marrjes në pyetje nga prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, regjistrin e takimeve me mbrojtësit ligjorë, regjistrin për regjistrimin e ankesave, etj.

Në lidhje me sa më sipër, i jemi drejtuar me shkresën nr. K4/I4-2 prot., datë 19.02.2021 Komisarariatit të Policisë nr. 1 Tiranë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të (CPT) për mbylljen e dhomave të sigurisë.

Komisariati i Policisë nr. 1, Tiranë, me shkresë nr. 1494/1 prot, datë 12.03.2021, ndërmjet të tjera na informoi se nga ana e tyre, janë marrë masa në zbatim të rekomandimeve të CPT në lidhje me kushtet në dhomat e sigurisë duke mbyllur 2(dy) dhoma sigurie të cilat nuk plotësonin kushtet kubike për qëndrimin e personave të ndaluar/arrestuar. Në vijim Komisariti i Policisë nr. 1 Tiranë na informon se, aktualisht funksionale në ambientet e komisarariatit është vetëm një dhomë për mbajtjen e personave të ndaluar/arrestuar, e cila plotëson standardet ndërkombëtare të jo më pak se 5m² për person, ku mund të qëndrojnë 2-3(tre) persona. Kapaciteti i dhomave të sigurisë për qëndrimin e personave të ndaluar/arrestuar është deri në 3 persona.

Në përfundim të hetimit tematik të kryer në Komisariatin të Policisë nr. 1 Tiranë dhe shqyrtimin e përgjigjes së dërguar nga ky institucion, konstatojmë se:

1. Nga kryerja e inspektimit, rezultoi se nuk është zbatuar plotësisht rekomandimi i CPT për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Komisarariatit nr.1 Tiranë, ku citohet: *“Të mos ketë dhoma sigurie më pak se 5m² dhe mos të mbahet më shumë se një person”*. Nga inspektimi rezultoi se vetëm njëra nga dhomat e sigurisë ishte e mbyllur.

Komiteti European për Parandalimin e Torturës (CPT) ka evidentuar në raportin përfundimtar për Shqipërinë të botuar në vitin 2019. Nisur nga gjetjet në përfundim të raportit, CPT ka rekomanduar: *“Krijimin e kushteve minimale për ajrim dhe ndriçim natyror në ambientet e dhomave të sigurisë. Të mos ketë persona të arrestuar/ndaluar në dhoma të sigurisë me sipërfaqe jo më pak se 5m², dhe mos të mbajnë më shumë se një person në dhomë”*³.

Situatën në Komisariatin e Policisë nr.1 Tiranë, të ambienteve të dhomave të sigurisë jashtë standardeve, ku kushtet janë të papërshtatshme i ka ngritur edhe Mekanizimi Kombëtar (MKPT) në mënyrë të vazhdueshme dhe ka adresuar rekomandime për përmirësimin e kësaj shtate, me qëllim mundësimin e një qëndrimi dinjitoz për personat e ndaluar/arrestuar në këtë institucion⁴.

Kjo situatë e rëndë cenon garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të personit të ndaluar/arrestuar, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

2. Mbyllja e dhomave të sigurisë në ambientet e Komisarariatit nr. 1 Tiranë, kishte për qëllim përmirësimin e kushteve dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor/nënligjor në fuqi “Për të drejtat dhe trajtimin e të ndaluar/arrestuar”, dhe domosdoshmëri, me qëllim përshtatjen sipas standardeve bashkëkohore.

Përdorimi i dhomave të sigurisë në ambientet e komisarariatit të policisë nr.1 Tiranë, për persona të ndaluar/arrestuar në kundërshtim të hapur dhe të plotë me aktet normative në fuqi nuk duhet të kalonte pa u analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë ndaj punonjësve që kanë kryer shkeljet ligjore. Këto shkelje të ligjit çenojnë rëndë të drejtat ligjore të shtetasve të ndaluar/arrestuar në kushte e dhomave të sigurisë.

Referuar përgjigjeve të autoriteteve shqiptare drejtuar CPT-së thuhet se është zbatuar plotësisht rekomandimi i CPT-së, për mos mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar në ambiente/dhoma që janë nën kubaturën dhe sipërfaqen minimale, më pak se 5m katror, në komisarariatet e policisë nr. 1, 2 dhe 3 të DVP Tiranë. Mbyllja dhe mos përdorimi i këtyre dhomave është bërë me urdhër të veçantë të D.P.P. Shtetit.

Është rasti të theksojmë se lidhur me plotësimin e standardeve të ambienteve të sigurisë dhe respektimin e të drejtave të arrestuarëve/ndaluarëve, rekomandimet e CPT-së dhe të Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato iu drejtohet. Këto rekomandime nuk iu drejtohet personave të caktuar personalisht, por institucioneve të administratës publike dhe drejtuesve të tyre me cilësinë e titullarit. Ne vlerësojmë se nuk është aspak serioze që me ndryshimin e titullarëve të institucioneve (Komisariateve të Policisë Tiranë) të ndryshojë edhe

³ Në zbatim të këtij rekomandimi të CPT, me urdhrin nr.1010, datë 14.08.2019 të DPP së Shtetit në Komisariatin e Policisë nr.1, Tiranë, duhet të ishin mbyllur 2 dhoma sigurie.

⁴ Rekomandim nr. K4/I15-2 prot., date 08.02.2019;
Rekomandim nr. K4/I80-2 prot., datë 11.05.2020;

qëndrimi ndaj rekomandimeve të bëra më parë nga CPT dhe Avokati i Popullit sikurse ka ndodhur dhe këtë rast me hapjen e dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë nr. 1 Tiranë.

3. Ndërsa nga informacioni me drejtuesin e këtij institucioni dhe nga administrimi i shkresës nr.1494/1 prot, datë 12.03.2021 rezulton se është funksionale një dhomë për mbajtjen e personave të ndaluar/arrestuar e cila nuk plotëson standardet ndërkombëtare të jo më pak se 5 m² për person, ku aty qëndronin 2 deri 3 persona.

Sjellim në vëmendje se standardi i parashkruar në kërkesat të Manualit: “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, ku sipërfaqja e dhomave të sigurisë nuk ishte sipas standardeve 10 m², të ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Në dhoma nuk kishte pajisje dhe orendi të nevojshme për jetesë si krevat, tavolinë, stola etj.

Sa më lart në analizë të këtij hetimi dalim në konkluzionin se, ambientet e sigurisë në këtë institucion nuk garantojnë sigurinë dhe kushtet jetesore për persona të ndaluar/arrestuar, ku të trajtohen me dinjitet duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63 të pikës 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëherëshme për mbylljen e dhomave të sigurisë ekzistuese në Komisaratin e Policisë nr.1 Tiranë, pasi ato nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret që garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të tyre, të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, si dhe zbatimi rekomandimi Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës (CPT).

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkohet të vihemi në dijeni, brenda afatit 30 ditë, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

ERMONELA XHAFA